



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA DRENAS

DREJTORATI PËR ARSIM

Dt. 17.01.2022, Nr. 09-111/01-2425



Në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, benë këtë:

RISHPALLJE TE KONKURSIT

1. Një punëtor/e tekniko –shërbyes (pastrues/e) në SHFMU"Xheladin Gashi – Plaku" në Komaran, deri sa të këthehet punëtori prej pushimit mjekësor, me mundësi vazhdimi.

KRITERET E PUNËSIMIT PËR PUNËTOR TEKNIKO – SHËRBYES:

- Shkolla e mesme

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Diploma origjinale, ose e vërtetuar në Komunë apo të Noteri publik.
3. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, jo më e vjetër se gjashtë muaj.
4. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim ose patentë shoferi)

REKRUTIMI:

Intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidateve do ta bëjë komisioni i DKA-së.

Në intervistë do të ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e këtij konkursi.

Kandidati i cili përzgjidhet nga komisioni intervistues obligohet që brenda afatit të ankesave ta sjellë në DKA çertifikatën mjekësore për gjëndjen shëndetsore lidhur me çështjen e punësimit, në të kundërtën do të nënshkruhet kontrata e punës me kandidatin e dytë më radhë për të cilin vlen e njehta rregullë.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurrimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në web faqen e Komunës së Drenasit.

Drenas,

Më:17.01.2022



Drejtor për Arsim

Muhamet Gjoka